

# NYFIKEN I EN STRUT




NJË LIBËR PËR FILLIMIN E PARASHKOLLËS



Sapo je bërë nënë ose baba. Ndoshta është hera e parë?


Herë pas here, mes ndërrimeve të pelenave, ndodhë me siguri të mendosh për punën e parashkollës. Së shpejti vjen koha e parashkollës dhe natyrisht që ke shumë pyetje për të cilat kërkon përgjigje.

Ne kemi tentuar që në këtë libër të mbledhim përgjigjet e pyetjeve më të rëndomta. Nëse dëshiron të dish edhe më shumë je i/e mirëseardhur në [www.helsingborg.se/kunskapsstaden](http://www.helsingborg.se/kunskapsstaden) ose të na vizitosh.



# NYFIKEN I EN STRUT

**NJË LIBËR PËR FILLIMIN E PARASHKOLLËS**




**FËMIJA IM NUK E  
DURON MIELLIN.  
A MUND  
TA ZGJIDHIN?**



**A MUND TË VAZHDOJË  
PUNËN E NATËS?**



**A TRAJTOHET  
FËMIJA ME BARAZI?**



**ÇFARË HANË?  
FËMIJA IM ËSHTË  
SHUMË NAZEMADH  
NË USHQIME.**



**SA KOHË TË GJATË  
ËSHTË PARASHKOLLA  
E HAPUR?**



**A DUHET TË BLEJË  
SHUMË GJËRA?**



**A KANË  
PARMAK SHKALLE?**



**KRÄM**



## Kur duhet filluar parashkolla?

Nuk mund të përgjigjemi me përpikëri në këtë pyetje meqenëse të gjithë fëmijët janë të ndryshëm. Veç kësaj është situata e familjes tënde ajo që ndikon në vendimin për kohën e nisjes së parashkollës. Natyrisht është fjala për një punësim apo një vend në një shkollim, apo gjëra të tjera që e ndikojnë përditshmërinë tuaj.

Parashkolla është për fëmijët mes moshës 1 dhe 5 vjeçare. Sot për sot shumica e prindërve dëshirojnë që fëmija i tyre të shkojë në ndonjë formë të parashkollës. Shumica e fëmijëve fillojnë në mes të moshës 1 dhe 2 vjeçare.

## Si ia del një fëmijë njëvjeçar të rrijë larg nënës dhe babait?

Padyshim që të gjithë fëmijët kanë nevojë për afërsi, butësi, siguri dhe dashuri që vijnë nga një relacion i palëkundur dhe jetëgjatë në jetën e tyre. Në të shumtën e herëve kjo vjen nga nëna dhe babai, por edhe nga kontaktet tjera të afërta si nga të afërmit familjar dhe miqtë.

Por një fëmijë ka nevojë edhe për stimuj tjerë. Porsa të lind fëmija fillon ta eksploroj botën. Më pastaj bëhet fjalë për relacione shoqërore me fëmijët dhe të rriturit tjerë, si të mësohet të pres radhën e vetë dhe të lozi, të dëgjojë dhe të mësojë nga tjetri, gjë që përbënë bazën e një vetëbesimi dhe të një aftësie jetëgjate të mësuarit.

Në parashkollë ne i shohim të gjithë fëmijët dhe te ne janë të mirëseardhur të gjithë – si të turpshmit ashtu edhe ata me zhvillim të parakohshëm. Ta takosh çdo fëmijë aty ku ai apo ajo gjendet është pjesë e natyrshme e profesionalizmit tonë pedagogjik.


## A është fëmija im i sigurt?

Lënia e fëmijës tënd te dikush tjetër për herë të parë përcillet pothuajse gjithmonë me një ngarkesë emocionale. Për këtë arsye koha fillestare parashkollë nis me një përshtatje në mjedisin e ri. Gjatë kësaj kohe ti dhe fëmija yt keni mundësi të na njihni si ne pedagogëve po ashtu edhe mjedisin e parashkollës. Edhe ti si prind do të marrësh pjesë në përshtatjen në mjedisin e ri gjatë një kohe kalimtare. Koha e përshtatjes është një kohë kur të jepet mundësia shtesë për të bërë pyetje.

Kohëzgjatja e përshtatjes së fëmijës me mjedisin e parashkollës mund të ndryshoj nga një fëmijë te tjetri dhe kur të jetë koha për fëmijën tënd, atëherë pedagogët e parashkollës tuaj do të flasin me ju se si do të duket përshtatja i fëmijës tënd. Të gjithë fëmijët janë unik dhe mirëpritur në bazë të nevojave të tyre individuale.

Ne që punojmë në parashkollë jemi të qetë dhe të sigurt në rolet tona. Për ne është e rëndësishme që ti të marrësh një përshtypje pozitive nga veprimtaria jonë dhe të kesh besim në ne dhe në detyrën e misionin tonë.

Të gjithë prindërit mendojnë se është e rëndësishme që fëmija i tyre të ketë kënaqësi, të marrë pjesë në lojëra, të ketë shokë dhe të ketë një mjedis zhvillues dhe stimulues me pedagogë të zgjuar dhe të arsimuar, që janë në nëdorësi të fëmijës së tyre, ndoshta si një kraharor ngushël-lues apo si një i rritur që inspiron, inkurajon dhe mbështet.



Ne jemi të interesuar të dimë se çfarë ti, si prind, mendon për ne, dhe në këtë aspekt ke mundësi të ndikosh veç tjerash përmes pjesëmarrjes në hulumtime të atitudave. Në këtë mënyrë mund të na ndihmosh që gjatë gjithë kohës të ndjekim dhe përmirësojmë cilësinë e veprimtarisë sonë.

Si i ka punët fëmija yt – luan dhe qesh – të tregojmë me gjithë qejf sa herë që të kemi rast.

Sa pedagogë jeni? Sa të mëdha janë grupet e fëmijëve? A janë grupet e fëmijëve me grupmosha të përziera? Këto janë pyetjet më të shpeshta nga ana e prindërve. Dhe përgjigja jonë është se ne jemi në numër të mjaftueshëm pedagogësh për tu dalë përballë kërkesave të gjithë fëmijëve. Madhësia e grupeve të fëmijëve mund të ndryshojë ca, varësisht nga ajo se me se merren fëmijët në momentin e caktuar. Brenda Qytetit të diturisë Helsingborg (Kunskapsstaden Helsingborg) ka edhe reparte me fëmijë me grupmosha të përziera si dhe fëmijë me grupmosha të njëjta. Gjeneratat e fëmijëve duken ndryshe nga vit në vit, dhe ne ia përshtatim veprimtarinë këtyre rrethanave. Dëgjohu me parashkollën tënde për mundësit që ekzistojnë mu në parashkollën në fjalë.


Kështu që përgjigja në pyetjen e rubrikës është: Po, fëmija yt është i sigurt në Qytetin e diturisë Helsingborg.

## **Unë punojë me orar të parregullt. Fëmija im ka një paaftësi. A është parashkolla edhe për mua?**

Të gjithë fëmijëve mes moshave 1 dhe 5 vjeç iu garantohet një vend në parashkollë. Këtë e thotë ligji. Kur është fjala p.sh. për fëmijë me paaftësi, ne kemi detyrë që secilin fëmijë ta presim nisur nga nevojat individuale të fëmijës. Si mbështetje për ne, pedagogët në Qytetin e diturisë Helsingborg, kemi veprimtarinë e Shëndetit të nxënësve (Elevhälsan). Me shumë endje të rekomandojmë të dëgjohesh me ne nëse ke pyetje rreth kësaj teme.

Qyteti i diturisë Helsingborg është i ndarë në zona shkollore. Një zonë shkollore përbëhet nga një apo më shumë shkolla me parashkollat përkatëse. Së paku një parashkollë për zonë shkollore është e hapur nga ora 06.00 deri në orën 18.00. Në parashkollat tjera të zonës shkollore orari i punës mund të ndryshojë pakëz, por ne natyrisht që jemi mirëpritës në përpjekjet tona për të gjetur një zgjidhje të mirë për ty dhe fëmijën tënd.

Për ty që punon në turnin e natës, ditëve të pushimeve ose me orar pune të parregullt ne kemi një parashkollë nate brenda Qytetit të diturisë Helsingborg. Për këtë parashkollë është një radhë pranimi e veçantë. Nëse dëshiron të dish më shumë për këtë parashkollë kontakto me ndonjërin nga asistentët e shkollave tona, që pastaj mund tu drejtojë tutje.



## Parashkolla e ka kuriozitetin në orarin e mësimit. A mund t'ia qëllosh përse?

Fëmijët mësojnë përmes lojës dhe për këtë arsye loja është shumë e rëndësishme për ne. Në parashkollë janë loja e fëmijës si dhe dëshira dhe endja për të mësuar, ato që udhëheqin aktivitetet tona. Mu të gjithë fëmijët dëshirojnë të mësojnë gjëra, lexim, shkrim dhe njehsim etj. Mësimi është gjëja që fëmijët bëjnë gjithë kohën dhe roli i pedagogut parashkollor është të jetë kureshtar dhe të kap atë që ndodhë në zhvillimin e fëmijës. Fëmijët përballen gjithë kohën me sfida përmes problemeve finoke në matematikë dhe suedisht. Ndoshta ne mund t'i rendisim makinat lodra me të cilat lozim sipas madhësisë? Apo të themi ngjyrën e xhaketave që ne veshim kur dalim jashtë? Ndoshta mund të njehim sa lugë na nevojiten kur shtrojmë tavolinën për ngrënie?

Kur mësojmë diçka, është gjithashtu e rëndësishme të flasim për ato gjëra që kemi mësuar. Bisedat mes nesh dhe fëmijëve, si dhe bisedat mes fëmijëve me njëri tjetrin, janë ato momente kur fëmijët me të vërtetë mësojnë! Që vetë të ritregojë një përrallë që ne e kemi lexuar ose të tentojë të shpjegojë se si kemi bërë kur patëm sukses të ndërtojmë atë kullën shumë të lartë me lego.

Në parashkollë i vëmë themelet e dëshirës për mësim. Por kjo duhet bërë në bazë të parakushteve të fëmijës dhe në taktin e vetë fëmijës. Ne kemi edhe një mendim që fëmija vetë të bëhet i vetëdijshëm mbi mësimin e vetë; vetë ta kuptojë se çfarë ka mësuar, si shkoj dhe si duhet bërë radhën tjetër. Ne pedagogët flasim me dëshirë për fëmijën “kompetent”.



Përveç mësimimit ne e kemi edhe një dimension shoqëror. Ne ushtrojmë në punën tonë të përbashkët që të dëgjojmë njëri tjetrin dhe të marrim parasysh njëri tjetrin. Mund të jetë aq e thjeshtë sa të tregosh për diçka që ke përjetuar, diçka që ke mësuar ose të demonstros diçka që dinë. Ne mendojmë që vetëbesimi, ose mbështetja në vete, është një veti e mirë për ta patur me vete në jetë dhe kjo është diçka që duhet të ushtrohet.

## A e ke ditur se edhe ne në parashkollë ndjekim një plan mësimor gjithashtu?

Në vitin 1998 parashkolla fitojë një plan mësimor të vetin. Parashkolla është dhe do të jetë, një pasqyrë e shoqërisë. Në planin mësimor mund të lexosh mbi detyrat e veprimtarisë dhe vlerat themeltare mbi të cilat mbështetet veprimtaria.

Është pjesë e detyrave tona të ndjekim se çfarë ndodhë me fëmijën tënd në parashkollë. Shumë parashkolla e mbledhin dokumentacionin në të ashtuquajturat portofol, një kopertinë, për çdo fëmijë, që gjendet në vend të arritshëm në repart në çdo kohë. Mendimi është që ne, ti, fëmija yt dhe neve, pothuajse në çdo kohë të ditës të mund të bisedojmë mbi përmbajtjen. Nuk ka nevojë të jetë fjala për diçka të jashtëzakonshme, vetëm disa fjalë që bëjnë që ti përherë të ndjehesh i informuar. Portofoli është një mënyrë për t'i qartësuar fëmijës se çfarë mëson në parashkollë.

Përmbajtja e portofolit bënë fjalë më së shumti për atë se çfarë ka bërë fëmija në parashkollë. Ai apo ajo zakonisht ka përshkruar, vizatuar apo ngjitur fotografitë ose objekte tjera vetë. Qëllimi është që vetë fëmija me ndihmën e portofolit të mund të tregoj se në çka ka marrë pjesë, çfarë ka mësuar dhe si ka mësuar. Edhe pedagogët mund të fusin shënime për vëzhgimet që kanë vënë re dhe që janë të rëndësishme për të dëshmuar mësimin e fëmijës.

Ne bëjmë gjithashtu një plan zhvillimi për fëmijën tënd, një PIZH (Plan Individual Zhvillimi). Kjo thjeshtë bëhet në mënyrë që ne të kemi mundësi të ndjekim zhvillimin e fëmijës gjatë gjithë periudhës kohore parashkollore. Kur fëmija yt p.sh. e lë parashkollën dhe fillon shkollën ose ndërron parashkollën dhe kalon në një parashkollë brenda Qytetit të diturisë Helsingborg ky plan mund t'i bashkëngjitet dokumentacionit tjetër. Plani i zhvillimit nisët nga parakushtet, nevojat dhe ëndërrimet e vetë fëmijës.

### **Kështu mund të duket puna pedagogjike gjatë një dite të zakonshme.**

Një fëmijë i yni tregonte se si kishte qenë lartë në Kärnan së bashku me gjyshin nga nëna. Atëherë grupi i fëmijëve fillonte të flasë për ndërtesa të larta. Ne mendo-heshim t'ia qëllojmë se sa e lartë është Kärnan dhe e krahasojmë me kulla të tjera të larta. Kur arritën në shtëpi ne kërkonim të dhëna në internet. Pastaj fillonim të vizatojmë, ngjyrosim dhe madje edhe të ndërtojmë ato kulla të ndryshme që kishim gjetur. Njëri nga fëmijët më të mëdhenj filloi të ndërtojë një kullë me gypa nga letra e trashë. Rezultati doli pakëz i shkallëzuar dhe jo plotësisht i drejtë në kënde gjë që bënte që kulla të binte përtokë gjatë gjithë kohës. Atëherë erdhi një fëmijë më i vogël që vuri disa blloqe të forta brenda gypave, dhe papritmas kulla u bë vërtetë e qëndrueshme. Fëmija i madh belbëzoi "Sa i mençur, përse nuk e mendova unë këtë?". Një shembull i mirë se si fëmijët mëson nga njëri tjetri!


Monica, pedagoge parashkollore

Ne i favorizojmë shumë bisedat e përditshme kur ti vjen për të marrë apo lënë fëmijën tënd, si momente kur ne mund të ndërrojmë pakë fjalë dhe të tregojmë se çfarë ka ndodhur gjatë ditës. Së paku dy herë në vit pedagogu së bashku me ty do të zhvillojë një bisedë gjatë së cilës shikoni planin individual të zhvillimit dhe flisni se si ia kalon fëmija yt në parashkollë.

### Një shembull tjetër nga veprimtaria e përditshme.

Ne fotozojmë dhe dokumentojmë shumë gjëra gjatë ditës. Dhe kur prindërit vijnë për të marrë fëmijët e tyre kanë mundësi të shikojnë në një ekran, ku rrotullohen fotografi të ndryshme, se çfarë kemi bërë ne. Para ca ditësh qëndronte aty një dyvjeçare dhe mendohej ti tregonte të ëmës me ato fjalë që dinte se kush ishin ata që dukeshin në secilën pamje të shfaqur në ekran. Nëna ishte e mendimit se ishte një mrekulli se sa e vëmendshme kishte qenë vajza në atë se çfarë bënin shokët dhe shoqet e saj gjatë ditës, dhe se çfarë kish ndodhur në të gjitha fotografitë.

Birgitta, pedagoge parashkollë



# Në të vërtetë çfarë bën njeriu në parashkollë? Si duket një ditë në parashkollë?

Ka një mendim prapa të gjitha atyre gjërave që ndodhin në parashkollë. Mund të duket pak si ndryshe nga një parashkollë në një parashkollë tjetër, por këtu po japim një shembull se si duket një ditë e rëndomtë te ne. Ne zhvillojmë veprimtari si brenda ashtu edhe jashtë parashkollës. Ne lëvizim shumë, ngase lëvizja është e mirë për drejtpeshimin dhe e bënë njeriun të fortë. Ne njehsojmë dhe lexojmë, hulumtojmë dhe ngjyrosim, ndërtojmë dhe luajmë me endje. Gjatë ditës ne kemi rutina kur ne ushtrojmë për t'i kaluar sfidat e përditshme, sikurse janë të ngrënit, larja e enëve, shkuarja në tualet, klasifikimi i gjërave dhe lidhja.



## Mëngjes.

Ti vjen te ne në parashkollë dhe nëna apo babai të ndihmon të varësh rrobat në vegën tënde apo t'i vësh ato në shportën tënde. Ne të përshëndesim me dorë dhe të urojmë ditë të mirë. Ata fëmijë që vijnë në parashkollë vërtetë herët hanë mëngjes. Ne të tjerët fillojmë ditën me lojëra sipas ëndjes derisa presim që shokët e tjerë të vijnë në parashkollë.



## Paradite.

Paraditja është e mbushur me këngë, muzikë, fruta, lëvizje, matematik, njohuri natyre, ngjyra dhe forma. Në ambient të brendshëm apo të jashtëm. Ndodhë që të kemi një projekt emocionues në nisje e sipër, ose bëjmë një shëtitje të shkurtër për në pyll apo bibliotekë. Së shpejti vjen koha e drekës. Atëherë të gjithë ndihmojmë ne shtrimin e tavolinës.





## Pasdite.

Pas drekës kemi pushimin. Atëherë mund të flesh një çast nëse ke nevojë për fjetje, përndryshe ke mundësi vetëm të shtrihesh dhe të pushosh. Pas pushimit ka më shumë gjëra për të bërë. Ne ndoshta shkojmë jashtë ose bëjmë diçka sipas ëndjes në ambient të brendshëm sikurse janë bubërimi, leximi i librave ose ndërtimi i gjëseneve në këndin e teknikës. Gjatë pasdites hamë vaktë të lehtë. Mund të jetë qumësht ose një sandviç. Së shpejti vjen nëna ose babai për të të marrë. Atëherë mund t'i tregosh diçka që ke bërë gjatë ditës. Ndokush nga pedagogët tregojnë se si kanë shkuar punët apo diçka që prindërit e tu kanë nevojë ta dinë para ditës së nesërme.





## Kërkohet guxim për të takuar botën!

Nëse ke mendime për të zgjedhur një parashkollë në Qytetin e diturisë Helsingborg dëshirojmë të dish që ne ndjekim një “pe të kuq” pedagogjik nga momenti kur fëmija yt fillon parashkollën dhe derisa ai apo ajo të lërë gjimnazin.

Mendimi është që fëmija yt të marrë nga parashkolla dhe shkolla sa më shumë të jetë e mundur. Bëhet fjalë për siguri, njohuri dhe aftësi, mundësi shoqërore si dhe vetëbesim. Gjëra që është mirë t’i kesh me vete për tërë jetën. Dhe është mirë të fillosh të ushtrosh me kohë.

Vizioni i Qytetit të diturisë Helsingborg është “të jetësojë ëndrrat e fëmijëve dhe të rinjve”. Parashkolla është hapi i parë. Një kërcim i parë gazmor.

# Pyetje dhe përgjigje.

## Kush mund të shkojë në parashkollë?

Parashkolla është për fëmijët e moshës 1 deri 5 vjeç.

## Kur duhet zgjedhur parashkolla?

Ti duhet të paraqesësh nevojën për parashkollë së paku katër muaj para se të kesh nevojë për vend në parashkollë.

## Si t'ia bëjë kur të zgjedhë parashkollën?

Për të paraqitur nevojën për vend në parashkollë duhet të plotësosh një formularë që quhet "Anmälan till behov av barnomsorg" (Paraqitja e nevojës për përkujdesje për fëmijë) dhe që gjendet në faqen e rrjetit, [www.helsingborg.se/blanketter](http://www.helsingborg.se/blanketter). Ti mundesh edhe të telefonosh Administratën e shkollës dhe aktivitetëve (Skol- och fritidsförvaltningen) të lira dhe të kërkoksh të ta dërgojnë formularin. Formulari i plotësuar dërgohet pastaj në Administratën e shkollës dhe aktivitetëve (Skol- och fritidsförvaltningen) të lira për qytetin e Helsingborg-ut ose dorëzohet në një shkollë. Për rregulla dhe rutinat që vlejnë mund të lexosh në faqen e rrjetit [www.helsingborg.se/kunskapsstaden](http://www.helsingborg.se/kunskapsstaden)

## Cilat parashkolla mund t'i zgjedhë?

Ti ke të drejtë të shprehësh dëshirën për cilëndo parashkollë brenda Qytetit të diturisë Helsingborg. Në formularin që e plotëson mund të renditësh një numër të ndryshëm alternativash të parashkollave ku ti mendon se mund ta dërgosh fëmijën tënd.

## A do të fitoj vendin në atë parashkollë që e kam zgjedhur?

Vendvendosja që ofrohet është në radhë të parë duke u nisur nga dëshira e kujdestarit të fëmijës dhe në radhë të dytë sa më afër vendbanimit të fëmijës. Varësisht prej numrit të kërkuësve, dhe në rast se ka rend për tu vendosur në ndonjë parashkollë, mund të ndodhë që të mos ketë mundësi të përbushen të gjitha kërkesat e radhitura të para.

## Sa kushton të kesh fëmijën në parashkollë?

Tarifa për një vend në parashkollë vendoset duke u nisur nga numri i fëmijëve që amvisëria në fjalë i ka të regjistruar në veprimtarin parashkollorë të qytetit si dhe të ardhurave bruto të amvisërisë në të cilën fëmija është i regjistruar si banues.

## Çfarë ndodhë nëse mbetem pa punë ose nëse ne shtohemi me fëmijë tjerë?

Fëmija e mbanë vendin në parashkollë dhe ka të drejtë në 15 orë në javë. Shpërndarja e kohës brenda javës mund të ketë dukje të ndryshme, varësisht nga parashkolla.

## Çfarë domethënie ka aklimatizimi?

Gjatë aklimatizimit fëmija yt mësohet me parashkollën e re, me shokët e ri dhe pedagogët që gjenden aty, sipas një takti që i përgjigjet vetë fëmijës. Përshtatja dhe aklimatizimi i secilit fëmijë bëhet sipas nevojës së fëmijës në fjalë dhe kohëzgjatja mund të jetë e ndryshme. Ti si prind do të marrësh pjesë pjesërisht gjatë kohëzgjatjes së aklimatizimit, për të qenë një siguri për fëmijën tënd si dhe për ta ndjerë veten të sigurt me ne.

## Çfarë bënë njeriu në parashkollë?

Parashkolla ka një plan të vetin mësimor me qëllime të caktuara, për jetësimin e të cilave punojmë. Veprimtaria pedagogjike e shkollës udhëhiqet nga kureshtja e vetë fëmijëve si dhe interesimet e tyre. Fëmijët mësohen t'i shprehin mendimet e tyre, të zhvillojnë vetëbesim në aftësitë e veta për të zgjidhur probleme, për të bashkëpunuar me njëri tjetrin dhe për shumë gjëra të tjera.

Për përgjigje dhe pyetje të tjera [www.helsingborg.se/kunskapsstaden](http://www.helsingborg.se/kunskapsstaden)





KUNSKAPSSTADEN  
HELSINGBORG

Qyteti i diturisë Helsingborg është emri i shkollave të qytetit të Helsingborg-ut.

Është fjala për disa qindra shkolla, prej parashkollave deri te gjimnazet,  
me mijëra bashkëpunëtor që do të ndihmojnë secilin fëmijë  
për të jetësuar ëndrrat e veta.

Ky është vizioni ynë.

Në mënyrë që një fëmijë të kalojnë mirë në jetë, kërkohet që dikush të vërejë talentin  
e tij dhe të nxitë këtë talent, e për këtë kërkohet shumë dituri dhe aftësi,  
fëmija duhet të ketë guxim të besoj në vetvete dhe të ndjejë një masë  
të mirë dëshire.

Kjo është ajo me të cilën punojmë çdo ditë. Dhe ne fillojmë në parashkollë.



HELSINGBORG

Qyteti i diturisë Helsingborg – një pjesë e qytetit të Helsingborg-ut.

Ilustrimet: Helena Ohlsson Foto: Anna Olsson







HELSINGBORG



KUNSKAPSSTADEN  
HELSINGBORG